# DËSHMI ARKIVI

**A-447379**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Kamikazi desh e hodhi mbi kofano”/ Parakaloi 4 makina me semafor të kuq dhe vijë të plotë, për pak për rplas të riun në Vlorë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391912.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 20:44:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 20:36:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 20:35:00 UTC → 15 shtator 2026, 20:37:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d73e9505307705906b3013ae793e0da41d63c0b830387265f466283bbca595a4` |
| TEKSTI | `5b3a6810ab8c3bd1be6c16617841100b8c77b598f69bdd1fefee187f6ac55664` |
| PAMJA | `dac436ea77ac3ed1facd374b9bd916177371510506a7a858b0d723e16182c283` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `939a1903c5b365d05abca2541e28f9af092267398b278cdc64a86df5111360bb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/939a1903c5b365d05abca2541e28f9af092267398b278cdc64a86df5111360bb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Kamikazi desh e hodhi mbi kofano”/ Parakaloi 4 makina me semafor të kuq dhe vijë të plotë, për pak përplas të riun në Vlorë

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 15.09.2026, 22:36

Share Share



Një qytetar i është drejtuar redaksisë së JOQ Albania për të denoncuar një manovër të rrezikshme në qendër të Vlorës.

Sipas denoncuesit, drejtuesi i një automjeti Audi me targë AB 103 ZF ka parakaluar 3-4 automjete të ndaluara në semafor, duke kaluar mbi vijë të plotë.

Në pamjet e dërguara në redaksi shihet momenti kur automjeti del nga vargu i makinave dhe vijon lëvizjen në korsinë e kundërt, ndërsa në atë moment semafori i këmbësorëve është i gjelbër.

Mjeti kalon pranë një të riu që po kalonte rrugën me skuter dhe, sipas pamjeve, për pak sa nuk e përplas.

Denoncuesi shprehet i shqetësuar për manovrën dhe kërkon që rasti të merret në konsideratë nga autoritetet.

“Një veturë në qendër të Vlorës tejkalon 3-4 vetura në vijë të plotë, që ishin të ndalura në semafor të kuq. Në atë moment, kur kishin dritën jeshile këmbësorët, për një fije floku nuk përplasi një djalosh. Kam video të qartë.”

Pamjet tregojnë një situatë ku një manovër e parakohshme mund të kishte sjellë pasoja të rënda për këmbësorin dhe përdoruesit e tjerë të rrugës.

Megjithatë, përgjegjësia për shkeljen dhe rrethanat e plota të ngjarjes mbeten për t’u verifikuar nga Policia Rrugore.

JOQ Albania publikon pamjet e dërguara nga qytetari, duke kërkuar që autoritetet të verifikojnë rastin dhe të marrin masat përkatëse nëse konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.